

Defamiliarization and its Social Effects: A research based on Sylvia Plath’s novel “The Bell Jar”

Sonila Shehu¹

Abstract

Has it ever occurred to you to do the same thing over and over again without noticing you’re actually doing it, thus making it seem as there is no end to the present act e.g. letting the door closed; not getting the thing that you want, placing the chair at the wrong spot?

Psychologically explained, these actions are defined as an unconscious behavior. In other words, it is about automatism or routine. We act unconsciously, without knowing. This leads to losing your connection with objects, events, and even people. This phenomenon affects not only our daily lives, but every possible aspect. It can even lead to language assimilation, due to the lack of usage of certain words. In some cases, it can affect relationships like mother-child. As Lauren Zane says “The sensation of holding a pen could easily be compared to our domestic relationships and settings which are likewise familiar to us. Much like not having to think about holding a pen to write with, a person does not have to think about having a relationship with her mother, because it is something that happens automatically:”

The consequences of this devastating familiarization are defined by Russian formalist, Victor Shklovsky in “Art as technique (1917). “Life is reckoned as nothing. Habituation devours work, clothes, furniture, one’s wife, and the fear of war. If the whole complex lives of many people go on unconsciously, then such lives are as if they had never been.”

In Shklovsky’s theory, there is a solution to break free from this familiarization, which is harmful for objects, events, humans, and society. “Art exists that one may recover the sensation of life; it

¹ Department of Communication Sciences, Bedër University College, Tirana, Albania, sshehu19@beder.edu.al

exists to make one feel things, to make the stone stony. The purpose of life is to impart the sensation of things as they are perceived and not as they are known.”

Definitions of prison objects and occurrences inside worlds and examples associated with them. The same thing happens with the definition of literature as the art of words or as a source of aesthetic pleasures, but the contribution of literature in society is way beyond this simple phrasing. This viewpoint, that Shklovsky defines in his work as defamiliarization, will be the focus of this research, with the help of Sylvia Plath’s “The Bell Jar”.

Keywords: Routinization, familiarization, perception, literature, society, technique, defamiliarization.

“Defamiljarizimi” dhe funksioni i tij social Bazuar te “Kambana e qelqtë” e Sylvia Plath-it.

Sonila Shehu²

Abstrakti

A ju ka qëlluar ndonjëherë që ta bëni një veprim dy-tri herë radhazi në mënyrë të përsëritur, pa e kuptuar se po bëni të njëjtën gjë dhe me ndjesinë që veprimin që dëshironi të bëni nuk e keni përfunduar, si: nuk e keni hapur derën, nuk e keni marrë gjënë që dëshironi, nuk e keni çuar karrigen në vendin e saj?

Shpjeguar nga shkenca e psikologjisë, ky quhet veprim i pavetëdijshëm. Por, i shpjeguar në një mënyrë tjetër, kjo ka të bëjë me automatizimin ose rutinizimin, sepse veprimet bëhen pa i menduar se po i bën, duke e humbur lidhjen me sendet, dukuritë apo njerëzit. Ky proces rutinizimi përfshin jo vetëm dukuri të jetës së përditshme, por çdo aspekt të jetës sonë. Ai mund të çojë deri në zhdukje të fjalëve apo humbje të gjuhëve, për shkak të mospërdorimit të tyre, madje deri në moskuptim të ekzistencës së marrëdhënieve të ndryshme, qoftë edhe ato nënë-fëmijë. “Ashtu si të mos mendojë

² Departament of Communication Sciences, Bedër University College, Tirana, Albania

Defamiliarization and its Social Effects: A research based on Sylvia Plath's novel "The Bell Jar"

për mbajtjen e një stilolapsi për të shkruar me të, një person nuk ka pse të mendojë të ketë marrëdhënie me nënën e tij, sepse është diçka që ndodh automatikisht.", thotë Lauren Zane.

Pasojat e këtij Familjarizimi shkatërrues që ndodh në jetën tonë, formalisti rus Viktor Shklovsky-i në shkrimin e tij "Arti si Teknikë" (1917), e jep kështu: "Dhe kështu jeta llogaritet si asgjë. Habitatizimi gllabëron punën, rrobat, orenditë, gruan e dikujt dhe frikën e luftës. "Nëse tërësia e jetëve komplekse të shumë njerëzve vepron në subkoshiençë, atëherë ekzistenca e këtyre jetëve është e barazvlerëshme me mosekzistencën e tyre".

Po tek teoria e Shklovsk-it gjendet një zgjidhje për të dalë nga ky familjarizim, i cili është kërcënues si për sendet, dukuritë, edhe për shoqërinë njerëzore në tërësi. "Dhe arti ekziston që njeriu të rikuperojë ndjesinë e jetës; ai ekziston për të bërë që dikush të ndiejë gjëra, ta bëjë gurin gur. Qëllimi i artit është të transmetojë ndjesinë e gjërave ashtu siç perceptohen dhe jo ashtu siç dihen."

Përkufizimet i ngurosin sendet dhe dukuritë brenda fjalëve dhe shembujve nëpërmjet të cilave ato sillen, kështu ndodh edhe me përkufizimin e letërsisë si art i fjalës apo burim i kënaqësisë estetike, por kontributi që në këtë rast letërsia i sjell shoqërisë është përtej çdo njohjeje njerëzore. Bazuar në këtë këndvështrim dhe rol të letërsisë, që ajo e realizon nëpërmjet një teknike që Shklovsky-i e quan Defamiljarizim, do të fokusohet edhe ky punim, duke u mbështetur në romanin e Sylvia Plath-it, "Kambana e qelqtë".

Fjalë kyçe: Rutinizim, familjarizim, perceptim, letërsi, shoqëri, teknikë, defamiljarizim.

Hyrje

Në veprën e saj Sylvia Plath, duke dashur t'i japë imagjinatës jetë, të bëjë një art lëvizës, e përdor defamiljarizimin ose duke e bërë të panjohur objektin apo dukurinë (duke e përshkruar si diçka të huaj për syrin, sikur nuk është parë ndonjëherë) ose komplikon formën. Asnjë përshkrim në roman nuk është i njëjtë, çdo gjë, edhe ato më të rëndomtë sillen në mënyrën më të çuditshme ose të ndryshuar, duke dashur të sjellë perceptime të reja.

Arti ekziston për të intensifikuar përvojën, sipas Shklovskit, prandaj qëllimi i tij është të promovojë atë lloj letërsie që i bën gjërat e njohura të duken të reja kur lexuesi bie në kontakt me to. Dhe duket se me këtë përcaktim më së miri përshkruan atë letërsi sikurse ajo e Sylvia Plath-it.

Qëllimi

Ky punim shkencor ka marrë shtysë nga vepra e shkrimtares Sylvia Plath “Kambana e qelqtë”, e një shkrimtareje, noveliste, poete amerikane e pasluftës (1932-1963), si një prurje interesante në letërsi për artin (zhvillimin e lirikës rrëfyese), por edhe për personalitetin e saj të veçantë, që reflekton në veprat e saj problemet e shëndetit mendor, depresionin, tentativat për vetëvrasje që në moshë të hershme, kurimi me elektroshok. Këtë roman autobiografik mund ta shohësh përmes këndvështrimeve të shumta dhe ndikimeve që ai ka pasur, si roman jo vetëm realist, por edhe me një prirje të fortë feministe, por mbi të gjitha, një roman i pakohë.

Zanafilla e këtij studimi ishte një nga teknikat që ka përdorur Sylvia Plath në të, “**Defamiljarizimi**”, teknikë kjo e njohur realiste, e përdorur edhe nga shkrimtarë të tjerë po kështu të kësaj prirjeje, sikurse Tolstoi, Gabriel Garsia Marquez etj., por që te Sylvia Path ka një veçanti, sepse shihet përmes syve të një femre, rrëfimtares-personazh, Esterit (vetë Sylvias), dhe lidhet pa diskutim me mënyrën sesi ajo e sheh apo percepton botën dhe çdo gjë që ka lidhje me të.

Qëllimi i këtij studimi nuk qëndron në mënyrë të ngushtë vetëm te mënyra sesi Plath-i e përdor këtë teknikë, por te forca që ka ajo për të ndryshuar perceptimet që nga gjëra të thjeshta, objekte e deri te norma e besime të rëndësishme shoqërore. Dhe përveç kësaj, pas leximit të romanit të Plath-it, kjo teknikë do aplikohet në fokus-grupe për të ndryshuar perceptimet e rutinizuara, por kjo e fundot do të jetë pjesë e një pune tjetër kërkimore.

Metodologjia

Në qendër të këtij studimi dhe si burim parësor hulumtimi është romani i Sylvia Plath-it "Kambana e Qelqtë". Në fillim do të analizohen shembujt e përdorur nga Plath-i, që kanë të bëjnë me teknikën e Defamiljarizmit sipas Shklovsky-it, duke analizuar mënyrën e veçantë të të aplikuarit të kësaj teknike nga Plath-i, si dhe asaj që ajo kërkon të arrijë përmes kësaj teknike, dhe më pas për t'i huazuar këto mënyra dhe për t'i aplikuar dhe ekspërimtuar në jetën reale. Metodatat janë cilësore, në pjesën e dytë të studimit do të vëzhgohet sesi njerëzit i perceptojnë gjërat dhe pastaj si ndryshon ky perceptim pas leximit të shembujve nga vepra e Plath-it.

Teoria e Defamiljarizmit sipas Shklovsky-it

"Defamiljarizimi" është një teknikë poetike që i bën lexuesit t'i shohin gjërat familjare në një mënyrë të çuditshme dhe jo familjare, në mënyrë që të ndikojnë tek ata për ta **ndryshuar** apo **përforcuar** perceptimin e tyre në lidhje me to.

Sipas Shklovsky-it, "Pasi e shohim një objekt, ne fillojmë ta njohim atë. Objekti është para nesh dhe ne e dimë, por ne nuk e shohim atë. Pra, nuk themi asgjë domethënëse për të. Arti i heq objektet nga perceptimi i automatizuar i tyre nëpërmjet disa mënyrave. Tolstoi e bën të njohurit të duket i çuditshëm, duke mos i përmendur emrat e sendeve, ai e përshkruan një objekt sikur ta shihte për herë të parë, një ngjarje sikur të ndodhte për herë të parë. Në përshkrimin e diçkaje ai shmang emrat e pranuar të pjesëve të saj dhe në vend të tyre emërton pjesë përkatëse të objekteve të tjera."

"Tolstoi i përshkroi dogmat dhe ritualet që sulmoi sikur ishin të panjohura, duke i zëvendësuar kuptimet fetare me kuptimet e përditshme të fjalëve. Shumë persona u "plagosën", ata e quajtën atë blasfemi duke e paraqitur tepër të çuditshme e monstruoze atë që ata e quanin të shenjtë. Reagimi i tyre ishte kryesisht për shkak të teknikës përmes së cilës Tolstoi perceptoi dhe pasqyroi ambientin e tij. Tolstoi zbuloi po ashtu për veten se perceptimet e tij e kishin shqetësuar besimin e tij"

Ilustrim për këtë teknikë është “Kholstormer”, historia që jepet nën kënvështrim e një kali për të shpjeguar irracionalitete të shoqërisë njerëzore.

“Në esenë me titull “T”i bësh gjërat të çuditshme: Parahistoria e mjeteve letrare”, Carlo Ginzberg përcakton dy senset e defamiljarizimit në letërsi dhe përafron secilën me veprën e një autori dhe sesi atë autor e pa Shklovsky. Të parën e shoqëron me Tolstoin dhe e përshkruan si: “Përdorimi i shfarosjes së një pajisjeje deleguese që vepron në çdo nivel- politik, shoqëror, fetar”. Kjo ndjenjë e “defamiljarizimit” në letërsi e ndihmon lexuesin të kuptojë shoqëritë shtypëse, stereotipat dhe aspekte të tjera që fshihen. Tolstoi përdori “shfarosjen” si pajisje letrare.

Ginzberg e shoqëron sensin e dytë me Marcel Proustin dhe e përkufizon atë si “një instrument që të arrihet një kuptim më i thellë i realitetit”. Sipas Lauren Zane, një tjetër studiuese e “defamiljarizimit” në veprat e Plath-it, shembull të së cilës iu drejtova më sipër me Carlo Ginzberg, të dyja këto forma të defamiljarizimit i shohim në artin e Plath-it.

Vlera e “defamiljarizimit” si teknikë vjen edhe në vlerën estetike që ajo i jep artit pa diskutim, si zgjim i imagjinatës.

Defamiljarizmi në veprën e Sylvia Plath-it “Kambana e qelqtë”

“Fitzgerald-i e kishte zakon të thoshte se ai shkruante me “autoritetin e dështimit” dhe kjo ishte e vërtetë, sepse ky fakt ishte burim fuqie në veprat e tij më të vona. Mirëpo “autoriteti i dështimit” nuk është veçse një hije e zbehtë në krahasim me “autoritetin e vetëvrasjes”, siç ndihet në veprat “Ariel” dhe “Kambana e qelqtë” të Plath-it. Dhe kjo jo ngaqë Sylvia Plath, duke i dhënë fund jetës së saj, u dha lexuesve shkasin makabër për t’u interesuar për veprën e saj, ndonëse pa dyshim është pjesërisht e vërtetë, por ngaqë ajo e dinte se ishte Lady Lazarus. Veprat e saj nuk na erdhën pas vdekjes. Ato u shkruan pas vdekjes. Midis vetëvrasjeve. Plath-i shkroi romanin e saj të vetëm dhe poezitë e Ariel-it si ndër ethe, si një njeri që mbahej në jetë me paterica dhe e dinte që ato po

Defamiliarization and its Social Effects: A research based on Sylvia Plath's novel "The Bell Jar"

thyheshin. A duhet të jemi mirënjohës për gjëra të tilla? A mund ta pranojmë çmimin që pagoi për atë që na fali? A është vërtet art vdekja? ..." (The New York Time) (Row, 1971)³

Ky përshkrim i Sylvia Plath-it apo Lady Lazarusit dhe mënyrës së adhjes së veprave të saj e bënë procesin e afrimit me këto vepra sa intrigues, po aq edhe të vështirë. Kanë qenë të shumta vlerësimët në kohë të ndryshme dhe studimet që kanë pasur në fokus veprat e saj "Kambana e Qelqtë" dhe "Ariel" dhe përherë ato kanë sjellë në dritë vlera të këtyre veprave.

"Kambana e qelqtë" u botua në 11 janar 1963, në Angli dhe jo në Amerikë (nuk u pranua nga producentët e saj), nën pseudonimin Victoria Lucas, romani është gjysmë autobiografik, por emrat e njerëzve dhe vendeve janë ndryshuar. Me emrin e saj të vërtetë, romani u botua në vitin 1967, ndërkohë që Plath-i ishte vetëvrarë.

Romani trajton jetën amerikane të viteve 50 dhe historinë e një 20-vjeçareje, Ester Greenwood, një studenteje të shkëlqyer, një vajzë e bukur dhe e talentuar, së cilës sapo i është dhënë mundësia e rrallë të bëjë një stazh në një revistë të famshme në NewYork-ut. Ajo bëhet pjesë e jetës metropolitane, por, si shumë të rinj e të reja të asaj kohe ajo çfarë ajo pret dhe ajo çfarë ajo gjen janë shumë larg njëra-tjetrës. Një rrëfim i magjishëm që e çon lexuesit deri në skutat e errëta të shpirtit të personazhit.

Nga vlerësimet e ndryshme që ky roman ka marrë dhe ato çfarë janë vlerësuar si një roman në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të grave, një roman i pakohë, është vënë në dukje se në roman dallohet edhe përdorimi i asaj teknike që kritikur rus, Shklovsky e quan "Defamiljarizim".

Për herë të parë dallimin e kësaj teknike në veprën e Plath-it e vë në dukje revista The New York Times: Te "Kambana e qelqtë", Sylvia Plath ka përdorur në mënyrë të shkëlqyer një nga teknikat më të rëndësishme të realizmit, atë që kritikur rus Shklovsky e ka quajtur "defamiljarizim". Realizmi i vërtetë e defamiljarizon botën tonë, kështu që ajo ngrihet nga pluhuri së zakonshmes dhe del sërisht në pah. Kjo është krejt e kundërta me atë realizmin kallp që na e paraqet botën si diçka të parë e të parë dhe të njohur mijëra herë, të cilën jemi përherë të gatshëm ta pranojmë." (Row, 1971)

3 <https://www.nytimes.com/1971/04/11/archives/the-bell-jar-by-sylvia-plath-296-pp-new-york-harper-row-695.html>

Ky vlerësim që i bëhet romanit shërben njëkohësisht edhe si një mënyrë për ta lexuar tekstin, duke e cilësuar romanin të llojit realist, por jo të realizmit si pasqyrim i rëndomtë i realitetit, por të një realizmi që rikthen perceptimet e humbura apo e bën lexuesin t'i njohë apo shohë ndryshe gjërat që ai i ka parë mijëra herë, por nuk i ka dalluar. Dhe për të realizuar këtë, ajo ka përdor "Defamiljarizimin".

Sipas Lauren Zane, vetë Plath-i nuk e përdori termin "defamiljarizim" në veprën e saj apo kur i drejtohej asaj, por komentet e saj për imagjinatën sugjerojnë që ajo ishte dakord me pikëpamjet e Shlovsky-it për artin. Dhe për të ilustruar këtë ajo sjell shembullin: "Ajo që kam frikë më së shumti, mendoj, është vdekja e imagjinatës. Nëse unë rri ulur dhe nuk bëj asgjë, bota vazhdon të bie si një daulle e ngathët, pa kuptim. Ne duhet të lëvizim, duhet të punojmë, duhet të ëndrojmë për të vrapuar para; varfëria e një jete pa ëndrra është shumë e tmerrshme për t'u imagjinuar ". (Plath, Johnny Panic dhe Bible of Dreams 272) (Zaun)⁴

Koncepti i defamiljarizimit lidhet me konceptin e perceptimit dhe njohjes së botës. Procesi i njohjes që nga dallimi i objektit e deri tek mënyra sesi sinjalet përcillen në trurin e njeriut për ta rikrijuar objektin e parë si edhe për ta lidhur këtë asosacion me emërtimin që ai mban si konvencion, është një proces kompleks. Prandaj, defamiljarizimi në perceptim është tepër i rëndësishëm.

Mënyra sesi Plath-i i defamiljarizon objektet, dukuritë dhe deri te normat shoqërore i përmban të dy mënyrat që Shklovsky përmend te "Arti si Teknikë", ose duke i bërë ato të duken të çuditshme në sytë e lexuesit ose duke i parë ato në një mënyrë të re, ndryshe nga herët e tjera. (Shklovsky, 1917)⁵

"Plath-i defamiljarizon edhe lexuesit e saj, duke i bërë gjërat e njohura të duken të reja, duke zbuluar elementet shtypëse të situatave dhe marrëdhënieve të njohura dhe duke shkatërruar konotacionet tradicionale me gjëra të njohura siç janë marrëdhëniet shtëpiake.", thotë një studiuese.

Te Plath-i, defamiljarizimi shihet i lidhur ngushtësisht me rizgjimin e imagjinatës, vlerë të cilën arti i letrësisë e mbart. Ky rizgjim në këtë rast nuk qëndron vetëm brenda dimensioneve të

4 Zane, Lauren, "Defamiliarization in the Domestic Poetry of Sylvia Plath"

5 Shklovsky, Victor, "Art as Technique", Essay, 1917

Defamiliarization and its Social Effects: A research based on Sylvia Plath's novel "The Bell Jar"

përjetimeve artistike, por ai bëhet mjet i rëndësishëm për ta njohur botën reale dhe për të mos humbur pjesë të jetesës në të, fragmente, ngjarje apo përjetime.

Në këtë mënyrë rizgjimi i imagjinatës, mosvdekja e saj, është një mjet që del jashtë veprës letrare dhe i vihet në shërbim njeriut në jetën e tij të përditshme.

“Më pëlqente t’i vëzhgoja njerëzit në situata kritike. Qoftë në ishte ndonjë aksident rrugor ose një zënkë në rrugë, qoftë një bebe e konservuar në një kavanoz laborator, do të ndalesha dhe do t’i vështroja aq shumë, sa t’i ngulitja fort në tru përgjithmonë.

“Padyshim, para se t’i kisha mësuar shumë gjëra që nuk do t’i kisha nxënë ndonjëherë në mënyrë tjetër, madje edhe kur më befasonin apo më shkaktonin neveri, nuk dorëzohesha kurrë, por hiqesha sikur e dija që të gjitha këto ishin pjesë e jetës⁶.” (Plath, 2017)

Nëpërmjet mënyrës sesi Personazhi i Esterit përshkruan procesin e vëzhgimit të situatave kritike dhe njerëzve në to, është një mënyrë njohjeje sa e veçantë, aq edhe e çuditshme, ajo përpiqet të tregojë rëndësinë e përqendrimit gjatë vëzhgimit dhe perceptimit. Këtë aspekt të vëzhgimit njerëzor që më pas automatizohet, Shklovsky e shpreh në këtë mënyrë: “Nëse shqyrtojmë ligjet e përgjithshme të perceptimit, shohim që ndërsa bëhet i zakonshëm, ai gjithashtu bëhet automatik. Kështu që përfundimisht të gjitha aftësitë dhe përvojat tona funksionojnë në mënyrë të pandërgjegjshme automatikisht.”

Në roman ka një larmi shembujsh të përshkrimit të sendeve të jetës së përditshme, por, tashmë të defamiljarizuara dhe të sjella me një mënyrë të re njohjeje, duke u rikthyer atyre kuptimin dhe vlerën e humbur, duke i epifanizuar. Si në rastin e telefonit fiks në këtë paragraf:

“Telefoni prej porcelani të bardhë ndanë shtratit mund të më kishte lidhur me botën, por ja që qëndronte i heshtur, si një kokë pa jetë. U përpoqa të sillja ndër mend gjithë njerëzit që u kisha dhënë numrin e telefonit, kështu mund të bëja një listë me emrat e telefonuesve të mundshëm, por të vetmen gjë që mbaja mend ishte se ia kisha dhënë numrin mamasë së Badi Uillardit, të cilin më pas ajo do t’ia jepte një përkthyesi simultan që njihte në KB.”⁷ (Plath, 2017)

6 Plath, Sylvia, “Kambana e qelqtë”, Tiranë, 2017

Mëyra sesi është defamiljarizuar objekti **telefon** përmes figurave të metonimisë, metaforës dhe krahasimit, ***mund të më kishte lidhur me botën, qëndronte i heshtur dhe si një kokë pa jetë***, në mënyrë të personifikuar sjellin imazhin e një koke njeriu të vdekur, që s'flet, përmes këtij përshkrimi autorja tregon dramën e vetmisë së kohës, vetminë e personazhit, dhe telefonin si një mjet i krijuar për të afuar distancën, por që nuk e kryente këtë funksion, fatkeqësisht nuk e lidhte me botën. Ideja që Plath sjell përmes këtij përshkrimi të thjeshtë në dukje, defamiljarizon konceptin e telefonit si një mjet lidhjeje me botën. Duket se këtu Plath shfrytëzon të njëjtën teknikë sikurse Tolstoi për të defamiljarizuar objektin, ajo shmang emrat e pranuar të pjesëve të tij dhe ato i zëvendëson me pjesët përkatëse të objekte të tjera, si në këtë rast, me imazhin e një koke pa jetë. Përveç kësaj, ajo përpiqet të zgjerojë kuptimin dhe funksionin që i jepet telefonit, si një mjet që përdoret kur të tjerët kanë numrin tënd, dhe sa më pak vetë ta kenë numrin, aq më pak telefonata do të ketë. Ky përshkrim sa familjar aq edhe defamiljarizues, bëhet duke i bërë objektet të duken të çuditshme, por me qëllim kthimin te njohja e vërtetë.

Ajo që Plath realizon është që e bën lexuesin të pyesë veten: A janë sendet ato që njohim ne, a e kryejnë ato funksionin që ne mendojmë, a e zgjerojnë ato komunikimin me botën apo vetëm ekzistojnë si objekte të ngrira pa vlerë?

E veçanta, risia dhe rëndësia që ka defamiljarizimi në veprën e Plath-it shkon përtej artit të fjalës, përtej imazhit, ajo ballafaqon besimet e veta, duke i vënë ato në dyshim dhe duke sjellë besime të reja.

“rrjedhë lumi, kalon pas Evës dhe Adamit ...

Po vrisja mendjen nëse gërma e vogël në fillim mund të nënkuptonte se në të vërtetë, asgjë e re nuk ka nisur ndonjëherë me gërmë të madhe, por thjesht ka rrjedhur prej asaj që e ka paraprirë. Eva dhe Adami ishte Adami dhe Eva, sigurisht, por ndoshta dhe kjo kishte ndonjë kuptim tjetër.

Mbase ishte pab në Dublin.” (Plath, 2017)⁸

Zanafilla sikurse e njohim prej historisë, kush ishte në fillim femra apo mashkulli dhe këtë e nyjëton veçse kjo “lojë fjalësh” e Sylvia Plath-it”.

⁸ Plath, Sylvia, “Kambana e qelqtë”, Tiranë, 2017

Defamiliarization and its Social Effects: A research based on Sylvia Plath's novel "The Bell Jar"

Ç'rëndësi ka si emërtohen gjërat, derisa koha ikën edhe konceptet evoluojnë, nuk ka gjëra të ngulitura përjetësisht, çdo gjë i nënshtrohet ligjit të ndryshimit.

Në botën e Esterit, atë të matriakatit, mund të jetë Eva dhe Adami dhe jo Adami dhe Eva, sikurse në zanafillën fetare të krijimit të botës. Një prishje e rregullit, si në këtë rast, nëpërmjet defamiljarizimit ka si funksion që të ndikojë te lexuesi për një rikonceptim apo të ngrejë pikëpyetje duke synuar të sjellë një mënyrë të re perceptimi.

Sylvia këtu flet jo vetëm për zanafillën, por, njëkohësisht, edhe për rrjedhën apo lidhjen mes gjërave apo konvencionet si në rastin e përdorimit të gërmës së vogël në fillim të fjalisë, duke hamendësuar që jo domosdoshmërisht çdo fjali nis me gërmë të madhe, apo tregon se po nis diçka e re, çdo gjë sipas saj vjen pas tjetrës në rrjedhë. Pra, nuk ka asgjë të re në botë, po vetëm pasim. Nën vështimin e një vajze sikurse Esteri, e cila vë në pikëpyetje shumë nga normat shoqërore të kohës, të cilat e kushtëzojnë femrën të ketë vetëm një model zgjedhjeje të jetës si femër: gruaja-bashkëshortja-nëna, çdo gjë shihet e perceptuar apo në kundërshtim me këtë imponim, në përpjekje jo vetëm për të Defamiljarizuar normat, konceptet, dukuritë, simbolet sociale, por përmes tyre për të çliruar unin e saj sa të brishtë e të pazëshëm.

Përsa i përket normave tradicionale shoqërore, nuk është e lehtë për asnjë shoqëri që ato të shihen ndryshe, të kundërshtohen, gjykohen, aq më tepër të ketë përpjekje për t'i ndryshuar.

Dihet dhe pranohet roli emancipues dhe avangardë i letërsisë në jetën shoqërore pothuajse në të gjitha periudhat e historisë së zhvillimit të njerëzimit. Dhe brenda këtij ndikimi është edhe vepra e Plath-it. Pavarësisht se në roman çdo aspekt i jetës është i pasqyruar përmes personazhit të Esterit, që nga marrëdhëniet që ka ajo me njerëzit, ngjarjet, përjetimet, ajo përfaqëson një pasqyrë të një brezi të tërë të rinjsh, por edhe të njeriut të kohës së saj.

Forcën kontradiktore të mospërputhjes mes modeleve që imponon shoqëria amerikane e viteve 50' dhe asaj çka ata gjenin e përjetonin në përditshmëri e shohim në shumë momente të romanit përmes përshkrimeve të rrëfimitares Ester.

Një ndër funksionet e defamiljarizimit në veprë është përpjekja për të ndryshuar konvencionet sociale nëpërmjet përshkrimit ndryshe të tyre, duke zgjuar dyshime në mendjen e lexuesve për simbolikën që ato nënkuptojnë.

Modeli i studentëve të Jelit sillet shpesh në vepër qoftë nëpërmjet të dashurit të Esterit, Badi Uilliardit, por edhe nëpërmjet prirjes së shoqërisë amerikane për të dalluar atë lloj klase sociale që kishte mundësi të studionte në Ivy League.

Prirja e kësaj shoqërie për të krijuar modele të tilla kompetitive dhe nga ana tjetër mosdhënia mundësi për të konkurruar është shpesh në qendër të romanit dhe rrëfimit.

“E vetmja gjë që dija të bëja ishte të fitoja çmime dhe bursa, por edhe asaj epoke po i vinte fundi.

Ndihesha si një kalë garash në një botë pa pista garash, apo si një kampion futbollit kolegji që papritmas përballej me Uoll Stritin, me një kostum zyrtar, ditët e lavdishme të të cilit u tkurrën në një kupëz të artë në sergjenin e tij, me një datë të gdhendur mbi të si data mbi një gur varri.” (Plath, 2017)⁹

Përshkrimi që Esteri i bën këtij realiteti është një goditje ndaj shoqërisë dhe këtë ajo e realizon duke u përpjekur të ndryshojë çfarë qëndron e ngulitur në mendjen e njerëzve, duke u përpjekur të defamiljarizojë koncepte tradicionale si:

- Roli i femrës në shoqëri.
- Roli i gruas në familje.
- Imponimi i modeleve mashkullore tradicionale në shoqëri.
- Krijimi i kulturës fallco të dukjes.
- E drejta për të bërë vetëm një zgjedhje në jetë.

“Pashë jetën time të degëzohej para meje si pema e gjelbër e fikut të tregimi.

Prej majës së një dege, si një fik i purpullak e rumbullak, më përshëndeste e më shkelte syrin një e ardhme e mrekullueshme. Njëri fik simbolizonte bashkëshortin me një shtëpi të lumtur dhe fëmijë, fiku i dytë simbolizonte një poet të famshëm, i treti një profesor të shkëlqyer, fiku tjetër, E.G.-në redaktoren e mrekullueshme, tjetri, Europën, Afrikën dhe Amerikën e Jugut; një fik tjetër simbolizonte Kostandinin, Sokratin, Atilën dhe një tufë dashnorësh të tjerë me emra të veçantë

⁹ Plath, Sylvia, “Kambana e qelqtë”, Tiranë, 2017

Defamiliarization and its Social Effects: A research based on Sylvia Plath's novel "The Bell Jar"

dhe profesione të çuditshme; një fik tjetër një kampione olimpike të famshme, dhe sipër e përtej këtyre fiqve edhe shumë të tjerë, që nuk mund t'i shquaja.

E pashë veten të ulur në bigëzimin e këtij fiku duke lënguar nga uria vetëm sepse nuk vendosja dot se cilin nga fiqtë do të zgjidhja. Unë doja gjithsecilin prej tyre, por po të zgjidhja njërin, do të humbja gjithë të tjerët, dhe tek rrija ulur atje, pa pasur mundësi të vendosja, fiqtë nisën të thaheshin e të bëheshin të zinj dhe, njëri pas tjetrit, ranë në tokë, pranë këmbëve të mia.” (Plath, 2017)

Duke u përpjekur të defamiljarizojë shumë aspekte jetësore, mite, bestyttni, këto vijnë në rrafsh të ndryshme dhe lidhen me kategori të ndryshme sociale, që nga figurat e grave e deri te vetë Esteri.

Romani ka shumë figura grash, shoqe e mikeshat të Esterit, por në jetën e saj duket se dy prej tyre kanë ndikimin më të madh, njëri është modeli që ajo nuk e pëlqen dhe nuk dëshiron ta ndjekë, nëna e saj dhe tjetra Xhej Sija, të cilën ajo e vlerëson dhe para së cilës atë e tradhton edhe vetja.

Përshkrimi që Esteri i bën Xhej Sijës, shefes së saj dhe redaktores së Lady's Day, ku Esteri punonte, nxjerr në pah zgjuarsinë dhe mençurinë, duke theksuar “se ajo nuk ishte nga ato gratë e kaparditura të revistave të modës me qerpikë falsë dhe bizhuteri marramendëse” (Plath, 2017, p. 12), çka tregon që figura e saj i kundërvihet modeleve femërore të kohës.

Ndjenja që Esteri ka ndaj Xhejit shkon deri në adhurim, kur ajo shprehet se do të donte të kishte pasur një nënë si Xhej Sija dhe atëherë do të dinte se çfarë do të bënte në jetë. (Plath, 2017, p. 45)

Ndërkohë që kur flitet për nënën e saj, duket se midis tyre ka një mungesë afrimiteti dhe një farë pakuptueshmërie, por Esteri e gjykon atë edhe për ngushtësinë e mendimeve dhe mosdhënien e ndihmës.

“Ime më nuk më vinte shumë në ndihmë. Që kur im atë u nda nga jeta, ajo kishte dhënë stenografi dhe daktilografi për të na mbajtur, por në fshehtësi ime ëmë e urrente këtë gjë dhe urrente edhe babanë pse vdiq dhe e la pa para, sepse ai nuk besonte te komisionerët e sigurimit për jetën. Ajo gjithnjë kishte dashur që pas kolegjit unë të mësoja stenografi, kështu do të kisha në dorë një zanat bashkë me një diplomë kolegji.” (Plath, 2017, p. 45)

Pasi reflekton për 19 vitet e jetës së saj, që i shfaqen në formën e shtyllave të telefonit, por që nuk vazhdonin më tej, pikërisht pas kësaj vjen portretizimi i figurës së nënës së saj (duke krijuar idenë se në këtë rrjedhë ka faj ajo). Ky përshkrim vjen i defamiljarizuar, duke e sjellë figurën e saj në mënyrë tepër të çuditshme, në fillim si një trung në mjegull, më pas ndalon te hunda e saj si e derrkucit, që e sjell si një kolonë të gjallë. (Plath, 2017)¹⁰

Për cilindo lexues, të cilësdo kohë, ky përshkrim do të ishte i vështirë për t'u pranuar, por deri diku ky lidhet edhe me personalitetin tepër kompleks "skizofrenik" të Esterit.

Duket se brenda Esterit ka një "urrejtje", një ndjenjë të fshehur e të pashpjeguar, që nga studiuesit lidhet edhe me elemente autobiografike të vetë Plath-it, marrëdhënien e saj të komplikuar me të ëmën, Aurelia Plath.

Është folur në fillim të këtij punimi për rolin emancipues të këtij romani, si në rrafshin simboliko-ideor, ashtu edhe përsa i përket teknikes letrare. Kështu Defamiljarizmi kthehet në një mjet të fuqishëm, i cili e shpëton personazhin kryesor nga drama e saj dhe gjithashtu i shërben zhvillimit shoqëror, duke rrëzuar modele të vjetra e duke ngritur mbi to modele te reja.

Konkluzione

Defamiljarizimi te "Kambana e qelqtë" pa diskutim që i shërben artit të imagjinatës, perceptimit, por njëkohësisht ai i shërben çrutinizimit. Nëse ndalesh te disa nga shembujt p.sh. raporti i Esterit me të ëmën, përshkrimi i kësaj marrëdhënieje bën që të ngrihen disa pyetje si: a mund të qëndrojë një marrëdhënie nënë-bijë apo bijë-nënë pa kontribuar për ta rritur e dhënë ushqim shpirtëror asaj? A i shërben ajo zhvillimit të fëmijës në rast se asnjëra prej tyre nuk përpiqet të kuptojë tjetrën, nëse nëna nuk e pranon se bija e saj është një individ tjetër ndryshe nga ajo, që ka mënyrën e saj të zhvillimit, kërkesat dhe pretendimet e saj?

10 Plath, Sylvia, "Kambana e qelqtë", Tiranë, 2017

Defamiliarization and its Social Effects: A research based on Sylvia Plath's novel "The Bell Jar"

Ashtu sikurse edhe Shklovski thotë, rutinizimi mund të bëjë që të humbasësh edhe këtë marrëdhënie me idenë e mirëqënë se ajo ekziston vetvetiu në mënyrë biologjike.

Pavarësisht frikës që mund të shkaktojë ballafaqimi me rinjohjen e gjërave, ajo që letërsia na jep si shembull tregon që "defamiljarizimi" është mjet shumë i mirë i njohjes së mirëfilltë, i mosrutinizimit të jetës dhe i rritjes së individualitetit. Brenda letërsisë është një mjet që zgjon imagjinatën dhe përcjell vlera estetike të pamasa te lexuesi si në nivelin e mendimeve ashtu edhe atë ndjesor.

Sugjerime

T'i njohësh gjërat për së pari ose t'i rinjohësh, duke rizgjuar senset, i jep imagjinatës jetë dhe jetës vlerë e kuptim.

Përpiquni t'i "defamiljarizoni" gjërat në jetën tuaj, për t'i njohur ju personalisht përmes eksperincës suaj.

Eksperienat e vërteta janë eksperiencia të reja, që kanë vlerë si për artin edhe për jetën reale.

Referenca

G. Perlof, Majorie, "A Ritual for Being Born Twice": Sylvia Plath's "The Bell Jar", Vol.13. No. 4 (Autumn, 1972), pp.507-522 (16 pages).

Ginzberg, Carlo, "Making Things Strange: The Prehistory of literary device", Representations, No.56, Special Issue: The New Erudition (Autumn, 1996), pp. 8-28, University of California Press.

Kate A, Baldwin, "The Radical Imagery of "The Bell Jar", Novel, A forum on Fiction, Vol.38, No.1 (Fall, 2004), pp.21-40, Duke University Press.

P. Gunn, Daniel “Making Art Strange: A Commentary on Defamiliarization”, *The Georgia Review*, Vol.38, No.1 (Spring 1984), pp.25-39 (9 pages).

Plath, Sylvia, “Kambana e qelqtë”, *Pegi*, Tirane, 2017

Shklovsky, Viktor, “Art as Technique”, *Essay*, 1917

Zane, Lauren, “Defamiliarization in the Domestic poetry of Sylvia Plath”, *Article*.

<https://www.nytimes.com/1971/04/11/archives/the-bell-jar-by-sylvia-plath-296-pp-new-york-harper-row-695.html>